

**STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR**

“IDEAL LIVE MARKETING” SHPK

PRONËSIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA

Neni 1

Ortaku i Vetëm

- 1.1 Shoqëria **“IDEAL Live Marketing” SHPK** (**“Shoqëria”**) është krijuar më datën si në vijim nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:

IDEAL Live Marketing GmbH, shoqëri e themeluar dhe regjistruar rregullisht e që funksionon sipas ligjeve të shtetit të Austrisë, e regjistruar në Zyrën e Taksave Austriake, me numër regjistrimi FN 226348s me seli në adresën Schmerlingplatz, 2/12, 1010 Vienë, Austri (më poshtë referuar si **“Ortaku i Vetëm”**), përfaqësuar nga Znj. Anisa Rrumbullaku me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm të datës **21 Tetor 2021**.

Neni 2

Emri

- 2.1 Emri i Shoqërisë është **“IDEAL Live Marketing” SHPK**.
- 2.2 Në të gjithë dokumentat, faturat, reklamat dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht mjeteve të përdorura për trasmetim, emri i Shoqërisë do të përbëhet nga këto elementë:
- i. fjalët *“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”* ose *“SHPK”*;
 - ii. numri unik i identifikimit (NUIS);
 - iii. kapitali i regjistruar dhe i paguar i Shoqërisë;
 - iv. adresa e selisë; dhe
 - v. njoftimi që shoqëria është në proces likuidimi, nëse është e aplikueshme

Neni 3

Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria do të ketë formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore në përputhje me parashikimet e ligjit shqiptar.



Neni 4
Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**”) si dhe parashikime të tjera të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 6
Selia / Adresa e regjistruar e Shoqërisë

- 6.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. “Margarita Tutulani”, Hyrja nr. 2, Ap. 12, Tiranë, Shqipëri.
- 6.2 Administratori zotëron të drejtën për të hapur ose mbyllur adresa sekondare të Shoqërisë në Shqipëri.

Neni 7
Objekti

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është konsulenca, marketingu promovimi dhe aktivitete të marrëdhënieve me publikun të llojeve të ndryshme për biznese dhe individë, menaxhim dhe organizim eventesh, marrëdhënia me median dhe çdo aktivitet tjetër të konsideruar të nevojshëm dhe përshtatshëm në mbështetje të aktiviteteve të mësipërme.
- 7.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose modifikohet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 8
Kapitali

- 8.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë në datën e hartimit të këtij statuti do të jetë 100 Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 100 Lekë (njëqind Lekë Shqiptare).
- 8.2 Ortaku i Vetëm zotëron 100% të kapitalit.

Neni 9
Transferimi i kapitalit/Kufizimet për transferimin

- 9.1 Ortaku i Vetëm është zotëruesi i vetëm i të gjitha kuotave të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.



- 9.2 Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, tek palë të treta vetëm përmes një akti të shkruar.
- 9.3 Kuotat e kapitalit të regjistruar transferohen me trashëgimi pa ndonjë akt të veçantë.

Neni 10 **Zmadhimi i Kapitalit**

- 10.1 Ortaku i Vetëm mund të zmadhojë kontributin e tij në kapitalin e regjistruar.
- 10.2 Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet gjithashtu me nënshkrimin dhe shlyerjen e kuotave të reja nga ortakët e rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 11 **Zvogëlimi i kapitalit**

- 11.1 Në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar do të kryhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni tregtar.

STRUKTURA DREJTUESE

Neni 12 **Vendimet e Ortakut të Vetëm**

- 12.1 Vendimet kryesore në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë merren me vendim të Ortakut të Vetëm, i cili është organi më i lartë i Shoqërisë dhe që gëzon të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj. Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohen në një regjistër vendimesh, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo fshihen. Për aq kohë sa ekziston vetëm një Ortak i Vetëm në Shoqëri vendimet e Ortakut të Vetëm do të merren në formën e një dokumenti të vetëm të shkruar dhe nuk do të mbahet procesverbal.
- 12.2 Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë ushtrohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga përfaqësuesi i Ortakut të Vetëm.
- 12.3 Vetëm Ortaku i Vetëm ka të drejtë të vendosë për çështjet si më poshtë:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Neni 13 **Administratori**

- 13.1 Administrimi i përditshëm i Shoqërisë do të bëhet nga 1 (një) ose më shumë Administratorë të caktuar dhe emëruar nga Ortaku i Vetëm.
- 13.2 Administratori ka kompetenca të plota për administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe të drejtën për miratimin e të gjitha vendimeve që mund t'i duken të përshtatshme për të realizuar dhe ushtruar objektin e Shoqërisë, me përjashtim të veprimeve që sipas ligjit, këtij Statuti apo vendimeve të Ortakut të Vetëm, të miratuara herë pas here, i takojnë Ortakut të Vetëm. Me anë të një prokure administratori mund të delegojë një ose më shumë nga të drejtat e tij në lidhje me menaxhimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë tek palë të treta.

Në vecanti, Administratori ka të drejtat dhe detyrimet në vijim në lidhje me administrimin e Shoqërisë:

- a. drejtimin e veprimtarisë së përditëshme të Shoqërisë, në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Ortakut të Vetëm, sipas rastit, të marra herë pas here;
- b. paraqitjen përpara Ortakut të Vetëm çdo muaj një raport që përfshin të gjitha faktet dhe rrethanat që mund të jenë të rëndësishme, rezultatet financiare të periudhës përkatëse, si dhe parashikimin për tremujorin në vazhdim;
- c. të vendosë për krijimin e filialeve të Shoqërisë në Shqipëri, blerjen dhe /ose disponimin e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera në Shqipëri dhe jashtë;
- d. të krijojë dhe/ose mbyllë degë dhe përfaqësi të Shoqërisë;
- e. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe kundrejt enteve publike;
- f. hapjen e llogarive të Shoqërisë në bankë;
- g. lidhjen e marrëveshjeve me palët e treta;
- h. lëshimin e faturave dhe shlyerjen e pagesave të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- i. punësimin dhe largimin nga puna të stafit të Shoqërisë dhe caktimin e pagave dhe rrogave të tyre apo shpërblimeve të tjera në përputhje me politikën dhe udhëzimet e miratuara nga Ortaku i Vetëm sipas rastit, herë pas here;
- j. marrja e të gjitha masave të reja për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë ditore të Shoqërisë nga pikëpamja ligjore dhe sipas këtij Statuti;
- k. mbajtja e librave të llogarive, siç përshkruhet nga ligji dhe parimet e kontabilitetit;
- l. përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë dhe auditimi i tyre nga auditorët e jashtëm nëse kërkohet nga ligji ose me vendim të Ortakut të Vetëm;



- 13.3 Administratori do të kryejë detyrën e tij për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, mandati i tij është i rinovueshëm, përveç rastit kur zëvendësohet sipas këtij Statuti. Në kryerjen e detyrës së tij, Administratori do të tregojë kujdesin e duhur të një personi të besueshëm dhe të ndërgjegjshëm të biznesit dhe do të respektojë fshehtësinë në lidhje me çështjet konfidenciale.
- 13.4 Administratori do të përfaqësojë Shoqërinë në veprimtarinë dhe administrimin e përditshëm dhe mban përgjegjësi për çështjet që janë të varësi të tij, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut.
- 13.5 Administratori i parë i Shoqërisë është Znj. Eva Margareta Wild, shtetase austriake, lindur në Villach më 07.12.1977 mbajtës i pasaportës nr. U 48811268.

Neni 14

Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia

- 14.1 Në vazhdim të detyrimeve të përcaktuara në Nenet 13, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të Shoqërive Tregtare, Administratori/ët duhet të:
- a. të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe në këtë Statut me mirëbesim dhe në interesin e Shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vëmendje të veçantë impaktit që ka aktiviteti i shoqërisë në mjedis;
 - b. të ushtrojë detyrën e tij në përputhje me të drejtat që i jepen nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe ky Statut vetëm për qëllimet e përcaktuara këtu;
 - c. t'i kushtojë vëmendjen e duhur çështjeve për të cilat duhet të marrë vendim;
 - d. të shmangë çdo konflikt aktual dhe të mundshëm ndërmjet interesave të tij personale dhe atyre të Shoqërisë;
 - e. të ushtrojë funksionet e tij me kujdesin dhe vëmendjen e duhur;
 - f. të vë në dispozicion të Ortakut të Vetëm çdo të dhënë të lidhur me biznesin, të kërkuara nga Ortaku i Vetëm, brenda një kohe të arsyeshme dhe jo më vonë se 7 (shtatë) ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të jenë të përditësuar.

Neni 15

Eksperti/ët Kontabël i/të Miratuar

- 15.1 Eksperti/ët Kontabël i /të miratuar do të caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm nëse është e nevojshme. Mandati i audituesit, nëse caktohet një i tillë, duhet të rinovohet çdo vit.

Neni 16

Viti Financiar

- 16.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, që fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31



Dhjetor të secilit vit.

Neni 17
Bilanci. Kontabiliteti

- 17.1 Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet dhe t'i paraqitet organeve tatimore përpara fundit të Marsit të vitit pasues.
- 17.2 Librat kontabël duhet të mbahen në gjuhën Shqipe dhe vlerat përcaktohen në monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të ndara në monedhë të huaj, dhe këto shuma do të konvertohen çdo muaj në monedhën vendase.
- 17.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim, Shoqëria mund të vendosë si garanci kuotat e saj, ose mund të vendosë të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 18
Likuidimi

- 18.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë shpërbërjen e Shoqërisë.
- 18.2 Me vendim të Ortakut të Vetëm do të emërohet një likuidator ose një grup likuidatorësh, të cilët do të merren me procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori/Likuidatorët do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban gjendjen e përgjithshme të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për kryerjen e këtij likuidimi. Në fund të këtij procesi, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë mbylljen e procedurës së likuidimit.

Neni 19
Ndryshimet në Statut

- 19.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të modifikohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 20
Dispozita Përfundimtare

- 20.1 Ky Statut përgatitet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Angleze dhe Shqipe. Në rast se ka mospërputhje midis këtyre dy versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën Anlgeze.

Nënshkruar më **25 Tetor 2021** nga:



**ORTAKU I VETËM
IDEAL LIVE MARKETING GMBH**

Përfaqësuar nga

Anisa RRUMBULLAKU

